

TRAJNIMI ELEMENTAR

Trajnimi elementar për kandidat për drejtor realizohet me qëllim që kandidati të pajiset me kompetencat e duhura profesionale për të menaxhuar, drejtuar me punën edukativo-arsimore dhe administrimin e punës në shkollë. Trajnimi elementar është i përbashkët-njëjtë për të gjithë kandidatët pavarësisht nga qëllimi i tyre për aplikimin e mëtejshëm për funksionin drejtor.

KUSHTET DHE MËNYRA PËR APLIKIMIN E KANDIDATËVE

Kandidatët për drejtor në shkollë fillore/të mesme fitojnë të drejtën për trajnim elementar në qoftë se kanë së paku arsim të lartë, plotësojnë kushtet për arsimtar apo bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore/të mesme dhe kanë së paku pesë vite përvojë pune në punën edukativo-arsimore.

Kandidatët për drejtor në konvikte nxënësish fitojnë të drejtën për trajnim elementar në qoftë se kanë së paku arsim të lartë, plotësojnë kushtet për edukator apo bashkëpunëtor profesional në punën edukativo-arsimore dhe kanë së paku pesë vite përvojë pune në punën edukativo-arsimore.

Kandidatët për drejtor në universitet i hapur qytetarë për mësim të përjetshëm fitojnë të drejtën për trajnim elementar në qoftë se kanë së paku arsim të lartë dhe kanë së paku pesë vite përvojë pune.

Aplikimi për trajnim bëhet në formë të shkruar duke parashtruar Fletaplikimin nr.1 i cili gjendet në ueb-faqen e QSHP-së.

Bashkë me fletaplikimin për trajnim kandidati duhet të parashtrojë:

- diplomë për kryerjen e arsimit të lartë adekuat;
- vërtetim mbi përvojën e punës në institucion edukativo-arsimor të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, të dhënë nga institucion kompetent;
- biografi e shkurtër (rezyme, Curriculum vitae);
- kopje të fletëpagesës së shumës së paguar për trajnim.

Aplikimet e kandidatëve dorëzohen dhe evidentohen në Qendrën Shtetërore të Provimeve.



ORGANIZIMI DHE REALIZIMI I TRAJNIMEVE

Realizimi i trajnimit sipas Programit, për kandidatët e paraqitur fillon pas formimit të grupit prej së paku dhjetë kandidatësh, të paraqitur për trajnim.

Kohëzgjatja e trajnimit është 192 orë dhe po kjo është me detyrim. .

Trajnimi realizohet në përputhje me Programin me gjashtë module, si vijon:

- Zbatimi i teknologjisë së informacionit dhe kompjuterëve në menaxhimin e arsimit;
- Teoria e organizimit;
- Njerëzit në organizatë;
- Drejtori si udhëheqës pedagogjik;
- Legjislacioni;
- Financat.

Trajnimi është i ndarë në:

- trajnim i drejtpërdrejtë i cili zhvillohet në kohëzgjatje prej 18 orësh për modul, të shpërndara në 12 sesione nga 90 minuta, që realizohen në periudhë prej dy ditësh, gjatë kohës së fundjavës
- punë individuale në kohëzgjatje prej 10 orësh për modul, kandidatët përgatitin punim seminarik me temë nga përmbajtjet e realizuara dhe i prezantojnë përpara grupit dhe trajnuesit.

ORGANIZIMI DHE REALIZIMI I PROVIMIT

Të drejtë për dhënien e provimit fiton kandidati i cili me sukses e ka përfunduar trajnimin elementar për drejtor dhe ka kaluar testin psikologjik dhe testin e integritetit për drejtor, i cili nuk duhet të jetë më i vjetër se dy vite.

Pas trajnimit të realizuar, kandidati aplikon për dhënien e provimit duke parashtruar flet aplikim pranë Qendrës Shtetërore të Provimeve. Bashkë me fletaplikimin kandidati parashtron: bartës të regjistrimit elektronik (CD) me gjashtë punimet seminarike nga modulet, vërtetimin që ka kaluar testin psikologjik dhe testin e integritetit, kopje të fletëpagesës së mjeteve të paguara dhe punimin seminarik përfundimtar në tri kopje të shtypura.

Temën e punimit seminarik përfundimtar kandidati e merr pas përfundimit të trajnimit, të gjeneruar në mënyrë kompjuterike (titullin me përzgjedhje të rastësishme e cakton softueri i sistemit elektronik nga lista e temave).

Provimi për drejtor përbëhet nga tri pjesë:

- verifikimi praktik i shkathtësive kompjuterike (60 minuta);
- verifikimi i aftësive për zbatimin e diturive teorike (60 minuta);
- prezantimi dhe mbrojtja e punimit seminarik (30 minuta).

Konsiderohet që kandidati e ka kaluar pjesën e parë dhe të dytë në qoftë se ka arritur 60% nga numri i përgjithshëm i pikëve.

Pjesa e tretë e provimit jepet në qoftë se janë kaluar me sukses pjesa e parë dhe e dytë.

Konsiderohet që kandidati e ka kaluar provimin në qoftë se i ka kaluar me sukses të gjitha pjesët e provimit.

Në qoftë se kandidati nuk e kalon provimin tri herë, i jepet vërtetim për moskalim.

Kandidatët të cilët pas herës së tretë nuk e kalojnë provimin dhe kanë pranuar vërtetim për moskalim, nuk kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimit në tre vitet e ardhshme. Pas kalimit të afatit në fjalë, kandidatët përsëri mund të ndjekin trajnimin dhe të aplikojnë për provim.

MËNYRA E MARRJES DHE VLEFSHMËRIA E CERTIFIKATËS

Kandidatit i cili e ka kaluar provimin i lëshohet certifikatë për drejtor, nënshkruar nga kryetari i Komisionit të provimit dhe nga drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve, në afat prej shtatë ditësh nga dita e përfundimit të provimit.

Vlefshmëria e certifikatës për drejtor përfundon në goftë se, kandidati për drejtor, i cili e posedon, nuk është përzgjedhur për drejtor në periudhë prej pesë vitesh nga dita e lëshimit të certifikatës.

RIPËRTËRIRJA E CERTIFIKATËS

Kandidatët të cilët janë pajisur me certifikatë për drejtor në përputhje me dispozitat të cilat kanë qenë në fuqi deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, ndërsa kanë për qëllim që po të njëjtën ta ripërtërijnë, duhet që më së voni deri më 1 shtator 2020 t'i nënshtrohen provimit për drejtor dhe të pajisen me certifikatë për drejtor në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Për këtë qëllim, kandidati pranë QSHP-së parashtron Kërkesë për dhënien e provimit për drejtor për ripërtërirjen e Certifikatës. Pas miratimit të kërkesës së kandidatit, i caktohet (gjenerohet) titulli për temën e punimit seminarik përfundimtar.

Kandidatët të cilët aplikojnë për ripërtërirjen e certifikatës, nuk e ndjekin trajnimin.

Kandidati mund të aplikojë t'i nënshtrohet provimit në sesione (terminë) të publikuara në ueb-faqen e QSHP-së. Për këtë qëllim plotëson Fletaplikimi nr. 2 dhe e dorëzon pranë QSHP-së duke i bashkangjitur dokumentacionin e duhur të cekur tek formulari Fletaplikimi nr. 2.

Sesionet e provimit vazhdojnë në kontinuitet gjatë tërë vitit.



Informacione më të hollësishme
në ueb-faqen e QSHP-së:

www.dic.edu.mk

Tel.: 02/3228-866

Mob.: 075/300-606

E-mail: obukidirektori@dic.edu.mk

UDHËRRËFYES për
TRAJNIME
DHE PROVIM

për drejtor në shkollë fillore
dhe shkollë të mesme,
konvikt nxënësish dhe
universitet i hapur qytetarë
për mësim të përzgjedhur

Organizimi dhe realizimi
i trajnimeve
Organizimi dhe realizimi
i provimit

Mënyra e marrjes dhe vlefshmëria
e certifikatës